



## DETËRË PROJEKTIMI

PËR REALIZIMIN E STUDIM-PROJEKTIMIT:

**“NDËRTIM I QENDRËS MULTIFUNKSIONALE DHE PARKIMIT NËNTOKESOR,  
BASHKIA BERAT”**



**STUDIM-PROJEKTIM**  
**“NDËRTIM I QENDRËS MULTIFUNKSIONALE DHE PARKIMIT NËNTOKESOR,**  
**BASHKIA BERAT”**

## 1 HYRJE

Bashkia e Beratit, kërkon të realizojë Studim-Projektim per “Ndërtim i qendrës multifunksionale dhe parkimit nëntokesor, bashkia Berat”. Duke pare zhvillimin e turizmit gjate viteve te fundit, eshte e nevojshme ndertimi i zonave te parkimit per te akomoduar turistet/vizitoret e ndryshem dhe rezidentet. Gjithashtu eshte e nevojshme projektimi dhe ndertimi i hapsirave publike ne sherbin te turisteve si galeri, eksposita, zona artizanale etj. Parkimi nentokesor dhe hapsirat mbeshtetese, do te ndertohej ne truallin ku ndodhet pallati ekzistues i kultures “Margarita Tutulani”.

### 1.1 Te pergjithshme

Berati (quajtur ndryshe dhe si qyteti i një mbi një dritareve) është qyteti i nëntë për nga popullsia në Republikën e Shqipërisë me një popullsi prej 60,031 (2011 census). Qyteti është qendra e Qarkut të Beratit. Gjendet në jugun e vendit, 70 km në vijë ajrore në jug të Tiranës, përshkohet nga lumi i Osumit dhe rrrethohet nga kodra dhe male, ku spikat Tomorri, i njohur si park kombëtar.

Berati si qytet eshte i ndertuar ne mes te kater maleve e te duket si një amfiteater antik. Mali i Tomorrit, Mali i Shpiragut, Mali i Gorrices dhe Kalaja. Ne mes te qytetit kalon Lumi Osum, qe e ndan Beratin ne dy pjese dhe qe lidhen nepermjet Ures se Gorrices, e cila ka shtate harqe.

Arkitektura mbreslenese e Beratit te le pa fjale, muret e shtepive jane te ndertuara me gure te skalitur ku shkelqejne nga bardhesia e gelqeres.

Berati duket sikur po merr gjithmonë e më shumë vëmendjen e munguar. Ai eshte një nga qytetet më të rekomanuara nga të gjitha agjensitë ndërkombëtare turistike, Berati është krenaria e arkitekturës shqiptare.

Vlerat e pasura të trashëgimisë historike, kulturore, etnografike, arkitekturore dhe natyrore të qytetit përbëjnë një bazë të fuqishme për zhvillimin e turizmit. Berati tanimë po tërheq një numër përherë e më të madh vizitorësh si nga Shqipëria ashtu dhe nga jashtë.

Ka një rivendosje të imazhit të mirë, sidomos këto dy-tre vitet e fundit, kur janë shtuar ndjeshëm flukset e vizitorëve nga vendi, nga Kosova e të huaj. Vërehet një riaktivizim i traditave më të mira të qytetit kundrejt vizitorëve.

Degë më e zhvilluar e turizmit deri më tani ka qenë punime të artizanatit. Artisanati, për qytetin është një vlerë e trashëguar e cila mirëmbahet edhe sot në Berat në disa gjini, si: gdhendje ne dru qendistari, punime ne argjend dhe ne metale te tjera, punime ne kashte, gdhendje ne pllaka guri, punime dekorative me gur.

Vitet e fundit ka një rigjallërim të ketyre mjeshtërive. Vizitori mund të gjejë në disa dyqane gdhendje me pamje karakteristike të Beratit. Punimet e disa prej mjeshtreve të Beratit janë shpërndarë edhe jashtë vendit.

Qyteti trashëgon nga e kaluara një varg të gjatë e të pasur vlerash historike, kulturore, etnografike, arkitektonike e të besimeve, të tilla që përbëjnë një potencial të konsiderueshëm për turizmin. Me burimet turistike të qytetit është e mundur që të zhvillohet turizmi familjar dhe ai i organizuar.

Gjithashtu një zhvillim te theksuar ka marre dhe industria e lehte ushqimore ku Berati eshte i famshem per perpunimin e ullirit, prodhimi i vajit te ullirit, si dhe prodhimin e veres.

**STUDIM-PROJEKTIM**  
**“NDËRTIM I QENDRËS MULTIFUNKSIONALE DHE PARKIMIT NËNTOKESOR,**  
**BASHKIA BERAT”**

## 2 PERSHKRIMI I PROJEKTIT

Qellimi i këtij projekti është ndertimi i një qendre multifunksionale dhe parkimit nentokesor e cila do te krijoje një pol te ri kulturor të qytetit si dhe një atraksion të ri si per qytetaret e Beratit por edhe për turistet vendas dhe të huaj. Ky projekt do të realizohet në truallin e Pallatit ekzistues të Kultures dhe ka tre komponente kryesore:

- Prishja e Pallatit ekzistues të Kultures “Margarita Tutulani”;
- Ndertimi i parkimit nentokesor dy kate nen toke me  $250 \div 300$  poste parkimi;
- Ndertimi i zones multifunksionale mbi parkimin nentokesor

## 3 SHEMBJA E PALLATIT EKZISTESE TE KULTURES

Konsulenti duhet të hartoje projektin baze dhe metodologjine e shembjes se pallatit ekzistues të kultures referuarë te gjitha standarteve kombetare ne fuqi. Konsulenti duhet të hartoje:

- Rilevimin e zones se pallatit ekzistues
- Raportin mbi gjendjen ekzistuese
- Metodologjine per prishjen e objektit duke marre parasysh lokacionin e tij
- Planin e organizimit te punimeve dhe rrethimin e kantierit



**STUDIM-PROJEKTIM**  
**“NDËRTIM I QENDRËS MULTIFUNKSIONALE DHE PARKIMIT NËNTOKESOR,**  
**BASHKIA BERAT”**



*Figure Foto Gjendjes Ekzistuese*

## 4 NDERTIMI I PARKIMIT NENTOKESOR

### 4.1 Te dhena dhe kerkesa te pergjithshme

Duke marre parasysh zhvillimin e turizmit ne qytetin e Beratit, duhet te parashikohen zona te ndryshme te cilat ofrojne sherbimet e parkimit te mjetave per qytetaret dhe turistet. Keto zona duhet te kene nje shperndarje sa me te moderuar ne pjese te ndryshme te qytetit me qellim per te siguruar nje akses sa me efektiv te mundshem.

Parkimi nentokesor i kerkuar ne zonen e pallatit ekzistues te kultures, do ti sherbeje si qytetareve ashtu edhe turisteve te cilet do te vizitojne qytetin e Beratit dhe ne vecanti lagjen Mangalem dhe Kalane. Kjo zone eshte ne afersi me shitetoren Osumi si dhe kufizohet me Rrugen Antipatre ne Veri & Veri-Lindje nderkohe qe ne Jug kufizohet me bulevardin Republika, duke siguruar nje akses te zgjeruar ne rruget kryesor te qytetit.

Referuar te dhenave te qytetit te Beratit, ne kete zone nevojiten rreth 200-300 poste parkimi. Duke llogaritur rreth 30 m<sup>2</sup>/post, siperfaqja totale maksimale e parkimit nentokesor perllogaritet rreth 8500 – 9000 m<sup>2</sup> e shperndare kjo ne dy kate parkim nen toke. Parkimi do te jete i pajisur me hyrje-dalje te kontrolluar pasi do te funksionoje si parkim me pagese.

**STUDIM-PROJEKTIM**  
**“NDËRTIM I QENDRËS MULTIFUNKSIONALE DHE PARKIMIT NËNTOKESOR,**  
**BASHKIA BERAT”**




Figure 1. Zona per ndertimin e parkimit

#### 4.2 Kerkesat konstruktive

Në këtë zonë gjatë hartimit të projektit dhe hyrje-daljes se parkimit duhen pasur parasysh Studimet Urbanistike te qytetit te Beratit. Gjithashtu, duke qene se parkimi do te jete nentokesor Konsulenti duhet te marre parasysh edhe projektin e mbrojtjes se skarpates gjate fazes se germimeve. Per hartimin e projektit konstruktiv duhet te merren parasysh Eurokodet si me poshte:

- Eurokod 1: Ngarkesat që veprojnë në ndërtesa,
- Eurokod 8: Projektimi i ndërtesave rezistente ndaj tërmeteve,
- Eurokod 3: Projektimi i strukturave metalike, ENV 1993,
- Eurokod 2: Projektimi i strukturave b/arre, ENV 1992,
- Eurokod 7: Projektimi i themeleve

#### 4.3 Sheshi i parkimit dhe rruget

Shtresat rrugore të trajtohen të tilla që të sigorojnë garanci për rrugën, qëndrueshmëri dhe të përballojnë kapacitetet faktike dhe të prespektivës. Të parashikohen trotuarë ne rruget dalese dhe hyrse gjithashtu dhe brenda vendparkimit. Materialet që do të përdoren, të janë sipas kushteve teknike ne fuqi.

Në përfundim mund të thuhet se projektuesi duhet të konsultohet vazhdimesht me Bashkinë Berat, përpala fillimit të punës për projektin, ashtu si edhe gjatë të gjitha fazave të projektimit dhe zbatimit

**STUDIM-PROJEKTIM**  
**“NDËRTIM I QENDRËS MULTIFUNKSIONALE DHE PARKIMIT NËNTOKESOR,  
BASHKIA BERAT”**

të tij dhe kjo si për garantimin e saktësisë së bazës së të dhënave ashtu edhe për reflektimin e ndryshimeve të pritshme nga plan/studimet e realizuar nga Bashkia.

Përveç saktësisë së të dhënave si më sipër, projektuesi, përpëra se të fillojë punën me projektimin duhet që paraprakisht:

- Të bëjë reliefin (azhornimin) e sipërfaqes së zonës;
- Të marrë të gjitha azhornimet e rrjetit të infrastrukturës,
- Të bëjë studimet përkatëse gjeologjike, hidrologjike etj

#### **4.4 Skema e rrjetit rrugor**

Hartimi i skemës shoqërohet me:

- relacion teknik;
- një analizë të situatës ekzistuese, në raport me efektet sociale që mund të sjellë projektin në drejtim të prishjes së ndërtimit dhe të elementeve të kosto-efektivitetit dhe te impaktit social, ekonomik, funksional dhe mjedisor

Qëllimi i kësaj faze është që Projektin të ketë analizë të përputhshmërisë me planet, eficencën ekonomike të ndërhyrjes, pra efektivitet të kostos, minimizim të impakteve negative sociale.

#### **4.5 Skema e qarkullimit/levizjes**

Projektuesi duhet të hartoje dhe të paraqesë paraprakisht, së bashku me skemën e rrjetit rrugor edhe analizën dhe skemën e qarkullimit/lëvizjes. Kjo skemë duhet të jetë Fletë e veçantë e projektit.

Projekti/skema duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë:

- Aksesibilitetin për të gjitha kategoritë e mjetave, duke përfshirë rastet dhe mjetet e emergjencës (sidomos ato të zjarrit, shendetit etj);
- Parashikimin e mënyrës së lidhjes së parkimit me akset kryesore
- Aksesibilitetin e këmbësorëve duke i dhënë një përparësi të qartë në rezervimin e hapësirës së lëvizjes si dhe duke parashikuar lidhjen e lëvizshmërisë së tyre në zonë;
- Aksesibiliteti i personave me aftësi të kufizuar;
- Të gjithë elementët e mësipërm të ndërthuren në një projekt sinjalizimi rrugor, në përputhje me projektet e Bashkisë si dhe duke siguruar një organizim të lëvizjes që përbush kërkasat si të banorëve ashtu dhe të aktivitetave të turistik të zonës;
- Plotësimin e elementeve të sigurisë rrugore duke trajtuar me kujdes të gjithë elementët (kalimet këmbësore, këndet e shikimit, ndriçimi, etj.).

Të trajtohet në projekt mënyra e lëvizjes si dhe masat e sigurisë së këmbësoreve gjatë punës për real

izimin e objektit në të gjitha fazat. Projektuesi duhet të paraqesi në flete të vecanta të gjitha detajet e nevojshme të masave të sigurisë që do të reflektohen edhe në preventiv. Skema e rrjetit rrugor dhe plani i propozuar i ndërhyrjes përlirim e sheshit të ndërtimit (prishjet) do të diskutohen me Bashkinë dhe mbasi të marrë miratimin e saj, Projektuesi vazhdon me detajimin në projekt-zbatimi.

#### **4.6 Ndricimi**

Ndricuesat do të parashikohen te tipit LED duke llogaritur lartësinë dhe fuqinë në raport me lartesine dhe hapsirat e brendshme te parkimit.

**STUDIM-PROJEKTIM**  
**“NDËRTIM I QENDRËS MULTIFUNKSIONALE DHE PARKIMIT NËNTOKESOR,**  
**BASHKIA BERAT”**

Furnizimi me energji i rrjetit të ndriçimit do të bëhet nga kabinat egzistuese të zonës. Në këto kabina do të instalohen panelet e ndricimit rrugor të cilat do ushqehen me ura të veçanta nga transformatori egzistues. Në kabinë do parashikohet dhe vendosja e matësve të energjisë. Do të parashikohet tokëzimi i shtyllave të ndriçimit.

#### 4.6.1 Rrjeti Elektrik

Projektet elektrike duhet te respektojne te gjitha konditat projektuese dhe standartet që janë sot në fuqi në Shqipëri (KTP – STASH) dhe për elementë speciale që nuk parashikohen në këto standarte duhet t'i referohemi Euro norms (EN), Eurostandardeve (EN, ED) dhe rekomandimeve të CEI, CENELEC, DIN, VDI/VDE

#### 4.6.2 UPS

Në ambjentet ku ka pajisje kompjuterike, elektronike të rëndësishme, pajisje sigurie dhe mbikqyrjeje, sisteme data dhe rack është e domosdoshme të përdoren furnizimi i tyre në mënyrë të garantuar dhe të pandërprerë. Këtë mënyrë furnizimi e sigurojnë pajisjet e ushqimit të pandërprerë, UPS.

Fuqia e këtyre pajisjeve duhet të mbulojë për një kohë të caktuar ushqimin e kompjuterave dhe pajisjeve të rëndësishme. Në varësi të skemës së furnizimit të objektit UPS duhet të kenë një autonomi nga 10 deri 20 minuta, kohë e cila mjafton për venien në punë të sitemit Gjenerator. Në mungesë të sitemit gjenerator, UPS-i duhet të sigurojnë ushqimin për aq kohë sa personeli të bëjë mbylljen manuale të pajisjeve të rëndësishme në mënyrë që të shhangen humbjet e informacionit dhe dëmtimin e paparashikueshëm të tij. Është e këshillueshme përdorimi i sitemit të përqëndruar UPS.

#### 4.6.3 Ndricimi i Emergences

Ndriçimi i emergjencës duhet të vihet në funksion vetëm pas ndërprerjes së energjisë dhe në rastet ekstreme kur ka detektim të zonave të zjarrit. Ndriçimi i emergjencës duhet të jetë me llampa 8-14W e shoqëruar me kitin me bateri. I gjithë sistemi do të jetë i kontrollueshëm.

Ndriçmi i emergjencës duhet të jetë i përfshirë në ndriçmin “exit”, ku krahas ndriçimit të nevojshëm, personeli ka të dallueshme edhe shenjat që tregojnë daljen. Duke qënë se ndriçimi i emergjencës kërkon ushqim nga bateritë ose edhe nga sistemi UPS i përqëndruar, është e rekomandueshme të përdoren ndriçues exit led, dmth. për shenjat treguese të përdoren llampat LED të cilat kanë konsum shumë të vogël dhe jetëgjatësi shumë të madhe.

### 4.7 Detektimi i zjarrit dhe sistemi i alarmit

Sistemi i detektimit të zjarrit duhet të përfshijë të gjithë objektin. Ky sistem duhet të jetë i ndarë në zona dhe secila prej tyre duhet të komunikojë në mënyrë të pavarrur me sistemin e shuarjes së zjarrit (sistemi i shuarjes me hidrant dhe me sprinkler). I gjithë sistemi do të jetë i bazuar në detektor tyni “Smoke Detector” të cilët duke qenë të gjithë të adresueshëm do të jepin informacionin e saktë përvendndodhjen e tyre dhe të zonës ku niveli i tymit është jashtë normave.

Ky sistem do të projektohet në një central intiligjent për zbulim, sinjalizim, alarm dhe fikje zjarri për ambiente të veçanta. Centrali do të jetë me ekran dhe shkrim në gjuhën shqipe me mundësi identifikimi individual të problemeve dhe shqetësimeve të ndryshme në funksionimin e sistemit. Gjithashtu, do të jetë i pajisur edhe me sistemin e sinjalizimit automatik të rrezikut zjarrit në qëndrën lokale të zjarrfiksave me anë të linjës telefonike. Dedektorët e tymit, temperaturës dhe gazit do të janë intiligjent dhe pulsantet manual të identifikueshëm individualisht. Sistemin i alarmit do të jetë i shoqëruar me sinjalizim me drithë sirene, etj. Projektuesi i sistemit të detektimit dhe alarmit do të parashikojë edhe një lidhje telefonike automatike ndërmjet panelit të kontrollit dhe komandimit të detektimit të zjarrit

**STUDIM-PROJEKTIM**  
**“NDËRTIM I QENDRËS MULTIFUNKSIONALE DHE PARKIMIT NËNTOKESOR,  
BASHKIA BERAT”**

në godinë me qendrën zjarrfikëse të qytetit. Rrjeti elektrik i sistemit të detektimit dhe alarmit është i veçantë nga rrjetet e tjera të godinës dhe përbëhet nga përcjellës bakri me tuba pvc fleksibel që nuk përcjellin djegien, nën dysheme apo suva, ose nga kabllo ekuivalente, gjithashtu në tuba.

#### **4.8 Sistemi CCTV dhe ACCES CONTROL**

Sistemi i vëzhgimit me kamera si një element i rëndësishëm për sigurinë e objekteve te ekspozuara dhe të gjithë objektit në térësi. Ai duhet të sigurojë jo vetëm cilësinë në shërbimin që ofron, por edhe vazhdimësinë dhe sigurinë në punë. Kjo cilësi realizohet nëpërmjet “Integrated Camera System”, ku të gjitha kamerat të janë dixhitale dhe të adresueshme.

Sistemin survejimit do të ketë kamera e monitore me ngjyra, instalimin e kamerave të tipeve të ndryshëm e me komandim. Videoregjistratori do të jetë digital me hard disk me mundësi lidhje në rrjet LAN4 me cilësi dhe kapacitet të lartë regjistrimi, ruajtje të tij dhe me kerkim të pamjeve sipas orës, dates, etj. Ato do të vendosen në hyrje të ndërtesës dhe brenda saj.

#### **4.9 Sistemi i Mbrojtjes nga Zjarri**

Impjanti i mbrojtjes nga zjarri do të jetë pjesë e impjantit MKZ të térë objektit. Ai do të përfshijë mbrojtjen e territorit si dhe të ndërtesës në brendësi. Ai do të projektohet në përputhje me normativat e sigurisë nga zjarri dhe në përputhje me normën UNI 9490 si dhe ato lokale në fuqi, sikurse ligji Nr. 8776, datë 5.4.2001, Vendimi K.M Nr.699, datë 22.10.2004”.

Në brendësi të ndërtesës, për çdo shkallë do të ketë magjistral me tub çeliku, pa tegel, me mure të trashë, si dhe hidrante në çdo kat. Uji për sistemin e zjarrit do të rezervohet për të siguruar një autonomi prej 3-6 orësh në përputhje me percaktimet e VKM Nr. 722, datë 19.11.1998.

Uji që do të përdoret për mbrojtjen nga zjarri do të rezervohet në, pranë ambientit teknik ku janë vendosur pompat e zjarrit. Ky sistem do të parashikojë pompat e shërbimit që janë të lidhura në parelë midis tyre dhe dimensionuar në mënyrë të tillë që të sigurojnë në mënyrë automatiqe një prurje të kërkuar komplesive dhe atë minimale të ujit të kërkuar kur punon vetëm njëra.

Ato mund të hyjnë në mënyrë automatiqe gjithashtu njëra pas tjetrës për të mbajtur presionin e kërkuar. Grupi i pompave ka në përbërje një pompë pilot e cila është e pajisur me një sistem automatik të provës për të verifikuar periodikisht funksionimin korrekt të tyre si dhe enë zgjerimi me membranë që shërben si një pajisje ideale kundër grushteve hidraulike në rrjetin e ujit.

Gjithashtu, për të evitar dëmtimet që mund të vijne nga një funksionim eventual me dërgim të mbyllur, pompat e shërbimit janë parashikuar me dalje për by-pass-in e qarkullimit të tyre.

Për të rritur sigurinë për motorrat elektrikë të pomave të zjarrit do të rezervohet furnizimi automatik me energji edhe nga rrjeti i motogeneratorit.

Sikurse e kemi theksuar më sipër, tubacionet e jashtëm të furnizimit me ujë do të janë me material plastik PEHD, PN20 për eleminim e korrodimeve, ndërsa brenda ndërtesës të janë me tub çeliku pa tegel me mure të trashë.

Për ambiente te veçanta sikurse ajo e IT, do të parashikohet mbrojtje me gaz Nr.2, si dhe sisteme të tjera si aerosol, pluhur, etj.

Po kështu, për ambientin teknik sigurimi nga zjarri duhet të parashikojë impiante me shkumë për mbrojtjen e depozitave të karburantit, si dhe sisteme “deluge” për mbrojtjen e transformatorëve dhe gjeneratorin.

**STUDIM-PROJEKTIM**  
**“NDËRTIM I QENDRËS MULTIFUNKSIONALE DHE PARKIMIT NËNTOKESOR,  
BASHKIA BERAT”**

#### **4.10 Sistemi i Furnizimit me uje dhe kanalizimet**

##### **4.10.1 Furnizimi**

Duke qene se parkimi do te kete hapsira mbeshtetese si tualetet e ndara sipas gjinive dhe tualetet per personat me aftesi te kufizuar, Konsulenti duhet te parashikoje rrjetin e furnizimit me uje. Norma e furnizimit do te jetë 150 l/ditë/banor. Materialet që do përdoren për tubacionet e ujësjellësit do jenë tuba polietileni HDPE-100 për 10 atm që plotësojnë normativat në fuqi, kanë përbërjen kimike dhe aftësinë mbajtëse ndaj presioneve të llogaritura. E njejtë gjë vlen dhe për pajisjet hidraulike dhe aksesorët. Saracineskat dhe pajisjet e tjera hidraulike që do te përdoren duhet të jenë  $P_n=16$  atm. Gjithashtu Konsulenti duhet te parashikoje sasine e ujit per mbrojtjen nga zjarri.

##### **4.10.2 Kanalizimet**

Qyteti i Beratit kohët e fundit ka pësuar ndryshime të dukshme në drejtim të shtrirjes së ndërtimeve duke ndjekur dy drejtime kryesore të cilat, në funksion te zhvillimit te tyre kanë sjellë probleme në rrjetin e kanalizimeve. Si drejtim i parë është rritja e intensitetit të ndërtimeve në zonat ekzistuese të ndërtimit dhe drejtimi i dytë është zhvillimi i ndërtimeve në zona pothuaj të pa zhvilluara më parë. Të dy rastet sjellin si rezultat rritjen e sasive të ujrale të zeza dhe ujrale të shiut respektivisht për shkak të rritjes së konsumit të ujit në zonë dhe rritjes së rrjedhës së ujrale të shiut.

Të verifikohet nëse ekziston Kanalizimi i ujërale të zeza si tille duhet spostuar ose duhet parashikuar nderhyrje, të vlerësohet nëse është e nevojshme për zonën e parashikuar për ndërhyrje.

Në rastin e ndërhyrjes, sa më sipër gjatë hartimit të projekt-zbatimit duhet të kihet parasysh:

- Të merret në konsideratë perespektiva 20 vjeçare e rritjes së popullsisë.
- Të kihet në konsideratë ruajtja e rrjetit ekzistues që ka kapacitetin e mjaftueshmë përcjellës dhe është në gjendje të mirë punë. Informacion më i detajuar duhet të merret pranë Sh.a. Ujësjellës-Kanalizime
- Drejtimi i zhvillimit urbanistik të zonës do të merret në Bashki.

Për sasitë e ujrale të zeza që derdhen në sistemin e kanalizimeve do të përdoren të dhënat e rekomanduara si më poshtë:

- $Q_{mes} = 194 \text{ l/ditë/banore}$
- $Q_{max} = 437 \text{ l/ditë/banore}$

Për sasitë e ujrale të shiut do të përdoren të dhënat e Institutit Hidrometeorologjik dhe mënyra e llogaritjes do të paraqitet nga projektuesi në mënyrë të argumentuar. Siguria llogaritëse e ujrale të shiut do të llogaritet 25 % për kolektorët kryesore dhe 40 % për kolektorët sekondarë. Vlera e llogaritjes së shiut të merret për periudhë përsëritje 1 herë në vit dhe kohëzgjatje prej 15 minutash.

Materiali kryesor ndërtimor, për kanalizimin do të jetë përdorimi i tubave prej politileni të brinjëzuar të llogaritura për të përballuar ngarkesat ose tubacione betoni me gota, pusetat dhe nënobjektet e tjera do të jenë me material betoni të armuar duke eleminuar përdorimin e materialit të tullës në sistemin e kanalizimeve që ka rezultuar me probleme. Megjithatë projektuesi do të argumentojë materialet që do të përdoren.

#### **4.11 Sistemi i detektimit te gazrave CO dhe NO<sub>2</sub>**

Gazrat CO dhe NO<sub>2</sub>, janë komponentet më tokësikë të mbetjeve të djegura të karburantit të makinave, situatë qe i bën shqetesues për sigurinë në strukturat e parkimeve. Prandaj duhet të merren masa për

**STUDIM-PROJEKTIM**  
**“NDËRTIM I QENDRËS MULTIFUNKSIONALE DHE PARKIMIT NËNTOKESOR,**  
**BASHKIA BERAT”**

parandalimin e arritjes së niveleve të patolerueshme të këtyre gazrave. Konsulenti duhet te hartoje një sistem detektimi automatik te këtyre gazrave në parkim i cili bashkëpunon me sistemin e ventilimit për ti mbajtur këto gazra brenda normave të lejuara. Duhet te parashikohet një central I ndare ne disa zona me sensorët perkates te cilet duhet te shperndahen ne pikat te ndryshme te parkimit per te siguruar mbulimin e te gjithe siperfaqes. Centrali duhet të ketë dalje për kontrollin e sistemit të ventilimit, e cila mund të jetë me një ose dy shpejtesi në varësi të standartit.

#### **4.12 Sistemi i ventilimit**

Edhe pse per një parkim mund te parashikohen hapje perimetrale për ventilimin natyral në kushte normale të funksionimit, parkimi klasifikohet nëntokson dhe i mbyllur ne qofte se këto hapje janë më të vogla se 60% e sipërfaqes së mureve anësore dhe më të vogla se 4% të sipërfaqes së parkimit. Si i tille, dhe ne pamundesi per te siguruar ventilimin natyral duhet te parashikohet ventilimi mekanik I parkimit.

##### **4.12.1 Ventilimi natyral**

Ventilimi natyral ka për qëllim që të garantojë parametrat të pranueshëm të cilësisë së ajrit për mosdëmtimin e shëndetit të përdoruesve të parkimit. Parkimi duhet projektuar në mënyrë që të sigurohet ventilimi natyral i tij duke garantuar një sipërfaqe ventilimi për çdo kompartiment parkim jo më të vogël se 1/25 e sipërfaqes së tij (4% e sipërfaqes së parkimit). Ne rast se ky kusht nuk sigurohet duhet te parashikohet edhe sistemi i ventilimit mekanik.

##### **4.12.2 Ventilimi mekanik**

Sistemi i ventilimit mekanik parashikon përdorimin e ventilatorëve aksiale për nxerrjen e tymit jashtë. Kompensimi i sasisë së larguar të ajrit bëhet nga grilat e ventilimit natyral, në kah të kundërt me pozicionin e ventilatorëve aksiale. Nevoja e përdorimit të ventilatorëve me zhvendosje do të analizohet nëpërmjet simulimit CFD. Ne cdo rast per sistemin e ventilimit duhet te percaktohen dhe filtrate perkates.

#### **4.13 Aksesi per personat me aftesi ndryshe (PAN)**

Eshtë qëllimi i këtij kapitulli që në çdo detyrë projektimi të sigurojë që të gjitha objektet me interes shoqëror dhe publik duhet të mbrojnë dhe parashikojnë përdorimin e objekteve edhe për personat me aftesi të kufizuara lëvizëse.

Në ambjentet e shërbimit, hapësirat e dyerive të hyrjes dhe të çdo njësie të patundshme duhet të janë të paktën 80cm. Hapësira e dyerive të tjera duhet të jetë të paktën 75cm. Lartësia e dorezave duhet të jetë midis 85 dhe 95cm (e këshillueshme 90cm) dhe për dritare në lartësinë 90~120 cm. Duhet t'u jepet përparësi zgjidhjeve me një kanat të vetëm për dyert që nuk kanë gjerësi më të madhe se 120cm dhe xhamat të janë vendosur në një lartësi 40cm nga plani i ecjes. Dyshemetë, disnivelet e mundshme të tyre nuk duhet t'i kalojnë 2,5 cm.

Rrugët horizontale dhe korridoret duhet të kenë një gjerësi minimale 100 cm dhe zgjerime të përshtatshme për të lejuar ndryshimin e drejtimit të lëvizjes nga ana e personit në karrige me rrata. Këto zgjerime duhet të realizohen në pjesët fundore të korridoreve dhe gjithashtu të parashikuara për t'u realizuar çdo 10m në zhvillim linear. Për pjesët e korridorit ose të sheshpushimeve ku hapen dyert duhen përshtatur zgjidhje teknike në përputhje me mënyrat e hapjes së dyerive dhe të hapësirave të lira të nevojshme për kalimin.

**STUDIM-PROJEKTIM**  
**“NDËRTIM I QENDRËS MULTIFUNKSIONALE DHE PARKIMIT NËNTOKESOR,  
BASHKIA BERAT”**

Shërbimet higjenike duhet të garantojnë manovrimin dhe përdorimin e pajisjeve të personave me aftesi të kufizuara motorike, duhet të parashikojnë afrim anësor te WC-ja dhe afrim ballor te lavamani. Kështu duhen respektuar përmasat minimale të mëposhtme:

- Hapësira e nevojshme e afrimit dhe e lëvizjes anësore e karriges me rrota te WC-ja dhe bideja, nëse është e parashikuar, duhet të jenë minimumi 100cm, e matur nga boshti i pajisjes sanitare.
- Hapësira e lirë për lëvizjen me karrocë për PAK duhet të jetë me sipërfaqe rrethore me diametër të paktën 150cm.
- Hapësira e nevojshme e afrimit ballor e karriges me rrota te lavamani, duhet të jetë minimumi 80cm e matur nga ana e përparme e lavamanit. Për sa i përket karakteristikave të pajisjeve sanitare, përveç të tjerash lavamanët duhet ta kenë pjesën e sipërme të vendosur në 80cm nga dyshemeja dhe të jenë pa kolonë me sifonin mundësisht gjysmë të myllur ose të futur në mur.
- WC-të dhe bidetë të jenë të tipit të varura, në mënyrë të vecantë boshti i WC-së ose i bidesë duhet të vendoset në një distancë minimale 40cm nga muri anësor, pjesa e përparme duhet të jetë më e madhe se 65cm nga muri mbropa dhe pjesa e sipërme duhet të jetë 45-50cm nga dyshemeja. Në rast se aksi i WC-së ose i bidesë është më shumë se 40cm largësi nga muri, duhet parashikuar në një distancë 40cm nga aksi i pajisjes sanitare një hallkë ose parmak për të lejuar lëvizjen. Paisja e lëshimit të ujit në WC të vendoset në lartësinë prej 70cm mbi sipërfaqen e dyshemesë.
- Të gjitha paisjet duhet të kenë kontrast të theksuar në ngjyrë nga dyshemeja dhe muret.
- Instalim i mekanizmit të hapjes së derës nga jashtë në rast dhënie të ndihmës së shpejtë.
- Instalim i sistemit të alarmit brenda banjos për t'u përdorur nga PAK në raste nevoje.

Në shërbimet higjenike të vendeve publike është e nevojshme instalimi i parmakëve pranë WC-ve, të vendosur me një lartësi prej 80cm nga dyshemeja dhe me diametër 3-4cm; nëse është i fiksuar në mur duhet vendosur 5cm larg nga vetë ai.

Në ambientet e shërbimit duhet të ketë kalim të sigurtë ndërmjet tavolinave dhe pengesave të tjera vertikale me gjëri si të paktën 100cm, për minimum 20% të sipërfaqes së shfrytëzueshme të ambjentit për shfrytëzim dhe shërbim.

- Banak dhe tavolina të realizuara në mënyrë të tillë që sipërfaqja e sipërme të jetë në lartësi 85cm nga dyshemeja, me gjëri si të paktën 70cm, me thellësi minimale 50cm, për minimumin e 20% të inventarit.
- Muret, dyshemetë dhe dyert të jenë të realizuara me nuanca ngjyrash në kontrast.
- Lloji i materialit që përdoret për shtrimin e dyshemesë të jetë i tillë që nuk e vështirëson lëvizjen e karrocave të PAK-ve.
- Dyert dhe muret ndarëse të punuara me sipërfaqe xhami më të mëdha se  $1.5m^2$ , pa transversale, duhet të jenë të shënuar dukshëm në lartësi prej 90 deri 160cm nga dyshemeja.

Tabelat e lajmërimeve duhet të vendoset në lartësi prej 120 deri 160cm.

Objekti duhet të përmbajë tabela orientuese për lëvizje në ndërtesë, të cilat duhet të jenë të realizuara në formë relievore që të plotësojë kushtet si në vijim:

- të jetë i vendosur horizontalisht deri në lartësi prej 90cm dhe vertikalish taret deri në lartësi prej 180cm nga kuota e dyshemesë;
- të jetë i vendosur pranë hyrjes së ndërtesës;
- të përmbajë informacion në shkrimin Braille;
- prej derës hyrëse të ndërtesës deri te plani të ketë vijë relievore drejtuese në kahje të lëvizjes;

Sipërfaqja publike - shtegu për këmbësorë duhet të jetë:

## STUDIM-PROJEKTIM

### “NDËRTIM I QENDRËS MULTIFUNKSIONALE DHE PARKIMIT NËNTOKESOR, BASHKIA BERAT”

- i ngritur në krahasim me bordurën së paku 3cm ose i ndarë me vijë relivore paralajmëruese, e nëse është në nivel të shiritit atëhere ndahet me sipërfaqe rrethore me diametër jo më të vogël se 150cm;
- i lidhur me sipërfaqet e tjera publike pa pengesë;


Ndryshimet e nivelit të sipërfaqeve publike - janë të lidhura me njëri-tjetrin me elementë përkatës përshtatje për ndryshim të lartësive.

Të gjitha ekspozimet në murin e ndërtesës pranë sipërfaqes publike për këmbësorë, si dhe ekspozimet e tjera në këto mure të cilat ndodhen në lartësinë 70 deri 220cm dhe të dala me shumë se 10cm, duhet të jenë të realizuara në tërë gjatësinë e tyre deri te sipërfaqja për këmbësorë ose të jenë të shënuara në mënyrë që sipërfaqja e këmbësorëve nën to të jetë e ngritur minimumi 3cm në krahasim me nivelin rrethues.

#### 4.14 Aneksi 1 – Foto ilustruese



**STUDIM-PROJEKTIM**  
**“NDËRTIM I QENDRËS MULTIFUNKSIONALE DHE PARKIMIT NËNTOKESOR,  
BASHKIA BERAT”**



**STUDIM-PROJEKTIM**  
**“NDËRTIM I QENDRËS MULTIFUNKSIONALE DHE PARKIMIT NËNTOKESOR,**  
**BASHKIA BERAT”**

## **5 NDERTIMI I ZONES MULTIFUNKSIONALE MBI PARKIMIN NENTOKESOR**

### **5.1 Qellimi dhe objektivat e projektit**

Qellimi i ketij projekti eshte ndertimi i nje Qendre Edukative per te rinte dhe e nje Muzeu Historik e cila do te krijoje nje pol te ri historik te qytetit per turistet vendas dhe te huaj si dhe nje atraksion te ri si per te rinte e Beratit ku do te mund te marrin dije te reja per teknologjine.

### **5.2 Te dhena dhe kerkesa te per gjithshme**

Sheshi i pozicionuar perballte nje prej lagjeve me te vjetra te Beratit qe ruhet dhe nga Unesco per vecantite e saj unike. Në këtë shesh nuk do të kemi një objekt por disa mini objekte me funksione të ndryshme.

#### **5.2.1 Zona e Hapsirave Publike**

Ne kete zone duhet te parashikohen ambientet e me poshtme:

- Muze Historik rrreth 200 m<sup>2</sup>
- Parkim nentokesor
- Hapesira per kurse per gatitore ku baze do te ishte IT dhe IA
- Laboratore dhe After school



**STUDIM-PROJEKTIM**  
**“NDËRTIM I QENDRËS MULTIFUNKSIONALE DHE PARKIMIT NËNTOKESOR,**  
**BASHKIA BERAT”**



#### 5.2.2 Salla per kurse pergatitore

Sallat e kurseve pergatitore do te jene ne sherbitim te nxenesve dhe studenteve te qytetit te Beratit, duke ofruar kurse te ndryshme ne me nje theks te vecante ne dezinjim:

- Programacion dhe Coddy school
- 3D modeling dhe Animacion
- Fotografi
- Graphic Design dhe Robotika
- Laborator dhe After School
- Verande e gjelberuar/shfrytezuar publike (mbi te gjitha sallat)
- Rivitalizim i hapesires se gjelberuar

**STUDIM-PROJEKTIM**  
**“NDËRTIM I QENDRËS MULTIFUNKSIONALE DHE PARKIMIT NËNTOKESOR,  
BASHKIA BERAT”**

### 5.2.3 Muzeu Historik

Muzeu do te permbaje:

- Hapesira eduktive
- Dyqan
- Librari
- Auditorium
- Hapesira te perkoshme ekspozite

## 5.3 Kërkesat e projektimit

Projekti duhet të ofrojë komoditetin dhe të gjitha kushtet e nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve te mesiperme. Objekti i studim-projektimit: “Ndërtim i qendrës multifunksionale dhe parkimit nëntokesor, bashkia Berat”. propozohet për ndërtim në truall ne pronesi te bashkise Berat, sipas të gjitha standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të projektimit të objekteve të ngjashme.

Në arkitekturën e godinës duhet të pasqyrohet jo vetëm koncepti bazë i të projektuarit sipas standardeve por edhe kërkesat urbanistike- arkitektonike të vendit tonë si dhe arkitektura me materialet bashkëkohore. Arkitektura e jashtme do te jape pershtypjen e disa mini objekteve qe do te nderthuren me natyren duke qene here ne dukje dhe here jo sipas kendeve te ndryshme te shikimit. Fokusi kryesor per kete shesh eshte qe te mbetet një hapesire e gjelberuar ku qellimi do te jetë te funksionaliteti dhe jo te ndertimi.

### 5.3.1 Projektimi per personat me nevoja te vecanta

Projektimi i ndërtesave duhet të sigurojë lëvizjen dhe qëndrimin e njerëzve me nevoja të veçanta, referuar legjislacionit përkates, për këtë kategori ndaj projektuesit duhen të bazohen në legjislacionin në fuqi por edhe në udhëzues ku janë paraqitur kushtet teknike më specifike

### 5.3.2 Ndricimi dhe fonia

#### 5.3.2.1 Ndricimi per muzeun dhe auditorin

Duhet të specifikohet përgjedhja e ndricuesve statik dhe automatik nga projektuesi duke patur parashysh te gjitha standartet kombetare dhe nderkombetare.

#### 5.3.2.2 Kabllot e ndricimit

Duhet të specifikohen kabllot dhe aksesorët në lidhje me hapesirat multifunksionale dhe muzen sipas standardeve ne fuqi dhe kerkesave te vecanta te Bashkise Berat.

#### 5.3.2.3 Pajisjet e fonise dhe komunikimit

Sistemet duhet të janë fleksibël dhe të konfigurueshme duke lejuar performance në shkalle të vogël e të mesme, per aktivitet e ndryshme qe parashikohen te realizohen ne te ardhmen.

### 5.3.3 Izolimi Termik

Izolimi termik duhet te parashikohet sipas legjislacionit ne fuqi (Ligji Nr. 8937 dt. 12.09.2002 „Për ruajtjen e nxehësise në ndërtesa“ dhe akteve nenligjore përkatese VKM Nr. 38 dt. 16.01.2003 „Për miratimin e normave, rregullave dhe kushteve te projektimit dhe të ndërtimit, të prodhimit dhe ruajtjes

**STUDIM-PROJEKTIM**  
**“NDËRTIM I QENDRËS MULTIFUNKSIONALE DHE PARKIMIT NËNTOKESOR,  
BASHKIA BERAT”**

së nxehësisë në ndërtesa“). Vëmendje të veçantë duhet tu kushtohet zonave të ashtuquajtura ura termike si p.sh. tavanet e mureve të jashtëm, pasi këtu temperatura e sipërfaqes mund të jetë më e ulët se sa ajo e elementeve konstruktive në zonat e rregullta.

#### 5.3.4 Izolimi Akustik

Pjesët e poshtme të mureve duhet të janë reflektuese në mënyrë akustike, d.m.th të forta siç janë druri, tulla, plasteri ose betoni. Duhet te parashikohen sistemet e fasades te tillë qe te realizojne izolimin akustik te muzeut nga zhurmat e jashtme.

#### 5.3.5 Projekti HVAC

Kushtet termike brenda ndërtesave duhet të janë të përshtatshme per aktivitetin qe kryhet ne to. Eshtë e nevojshme që projektyuesi të marrë në konsideratë funksionin e mjediseve dhe aktivitetin që kryhet. Impiantet mekanike janë mjaft të rëndësishme për funksionimin e një godine dhe zhvillimin Projektet, punimet e zbatimit dhe shfrytëzimit nga përdoruesit mbështeten në kuadrin ligjor dhe V.K.M-të e Republikës së Shqipërisë dhe në rastet kur ky kuadër nuk parashikon terma ose argumenta të veçantë, ato mbështeten në standartet, norma dhe udhëzime kryesisht italiane (UNI,UNIEN) dhe europiane (ISO, EN).

##### 5.3.5.1 Ventilimi

Ventilimi i objektit te projektohet i tille qe te garantoje cilesine e ajrit permes ventilimit natyror. Ne ambientet qe ventilimi natyror nuk eshte i mundur, ateher te mendohet zgjidhja nepermjet sistemeve artificiale te ventilimit. Duke qënë se në ambientet e muzeut kemi të bëjmë me zona me densitet të lartë të popullimit, sistemi i ventilimi për këto ambiente duhet të projektohet në mënyrë të tillë që të arrije të plotësojë qellimet kryesore të aplikimit sipas standardeve nderkometare (kryesisht italiane).

##### 5.3.5.2 Impianti I ajrit te kondicionuar

Impjanti i Ajrit te Kondicionuar duhet të jetë një sistem qendror i afte te garantoje ne menyre te pavarur kushtet e komfortit termik ne cdo ambient te godines si zonat e publikut, ambientet suportuese, ambientet administrative si dhe ambientet ndihmese dhe te shërbimit.

#### 5.4 Sistemi i detektimit te zjarrit

Sistemi i detektimit të zjarrit duhet të përfshijë të gjithë objektin. Ky sistem duhet të jetë i ndarë në zona dhe secila prej tyre duhet të komunikojë në mënyrë të pavarur me sistemin e shuarjes së zjarrit (sistemi i shuarjes me hidrant dhe me sprinkler). I gjithë sistemi do të jetë i bazuar në detektor tymi “Smoke Detector” të cilët duke qenë të gjithë të adresueshëm do të jalin informacionin e saktë për vendndodhjen e tyre dhe të zonës ku niveli i tymit është jashtë normave.

Ky sistem do të projektohet në një central intiligjent për zbulim, sinjalizim, alarm dhe fikje zjarri për ambiente të veçanta. Centrali do të jetë me ekran dhe shkrim në gjuhën shqipe me mundësi identifikimi individual të problemeve dhe shqetësimeve të ndryshme në funksionimin e sistemit. Gjithashtu, do të jetë i pajisur edhe me sistemin e sinjalizimit automatik të rrezikut zjarrit në qëndrën lokale të zjarrfiksave me anë të linjës telefonike. Dedektorët e tymit, temperaturës dhe gazit do të janë intiligjent dhe pulsantet manual të identifikuveshëm individualisht. Sistemin i alarmit do të jetë i shoqëruar me sinjalizim me dritë sirene, etj. Projektyuesi i sistemit të detektimit dhe alarmit do të parashikojë edhe një lidhje telefonike automatike ndërmjet panelit të kontrollit dhe komandimit të detektimit të zjarrit në godinë me qendrën zjarrfikëse të qytetit. Rrjeti elektrik i sistemit të detektimit dhe alarmit është i

**STUDIM-PROJEKTIM**  
**“NDËRTIM I QENDRËS MULTIFUNKSIONALE DHE PARKIMIT NËNTOKESOR,**  
**BASHKIA BERAT”**

veçantë nga rrjetet e tjerë të godinës dhe përbëhet nga përcjellës bakri me tuba pvc fleksibel që nuk përcjellin djegien, nën dysheme apo suva, ose nga kabllo ekuivalente, gjithashtu në tuba.

### **5.5 Acces Control dhe CCTV**

Sistemi i vëzhgimit me kamera si një element i rëndësishëm për sigurinë e objekteve te ekspozuara dhe të gjithë objektit në tërësi. Ai duhet të sigurojë jo vetëm cilësinë në shërbimin që ofron, por edhe vazhdimësinë dhe sigurinë në punë. Kjo cilësi realizohet nëpërmjet “Integrated Camera System”, ku të gjitha kamerat të jenë dixhitale dhe të adresueshme.

Sistemin survejimit do të ketë kamera e monitore me ngjyra, instalimin e kamerave të tipeve të ndryshëm e me komandim. Videoregjistratori do të jetë digital me hard disk me mundësi lidhje në rrjet LAN4 me cilësi dhe kapacitet të lartë regjistrimi, ruajtje të tij dhe me kerkim të pamjeve sipas orës, dates, etj. Ato do të vendosen në hyrje të ndërtesës dhe brenda saj.

### **5.6 Sistemi i mbrojtjes nga zjarri (MKZ)**

Impjanti i mbrojtjes nga zjarri do të jetë pjesë e impjantit MKZ të tërë objektit. Ai do të përfshijë mbrojtjen e territorit si dhe të ndërtesës në brendësi. Ai do të projektohet në përputhje me normativat e sigurisë nga zjarri dhe në përputhje me normën UNI 9490 si dhe ato lokale në fuqi, sikurse ligji Nr. 8776, datë 5.4.2001, Vendimi K.M Nr.699, datë 22.10.2004”.

Në brendësi të ndërtesës, për çdo shkallë do të ketë magjistral me tub çeliku, pa tegel, me mure të trashë, si dhe hidrante në çdo kat. Uji për sistemin e zjarrit do të rezervohet për të siguruar një autonomi prej 3-6 orësh në përputhje me percaktimet e VKM Nr. 722, datë 19.11.1998.

Uji që do të përdoret për mbrojtjen nga zjarri do të rezervohet në, pranë ambientit teknik ku janë vendosur pompat e zjarrit. Ky sistem do të parashikojë pompat e shërbimit që janë të lidhura në parelë midis tyre dhe dimensionuar në mënyrë të tillë që të sigurojnë në mënyrë automatiqe një prurje të kërkuar komplesive dhe atë minimale të ujit të kërkuar kur punon vetëm njëra.

Ato mund të hyjnë në mënyrë automatiqe gjithashtu njëra pas tjetrës për të mbajtur presionin e kërkuar. Grupi i pompave ka në përbërje një pompë pilot e cila është e pajisur me një sistem automatik të provës për të verifikuar periodikisht funksionimin korrekt të tyre si dhe enë zgjjerimi me membranë që shërben si një pajisje ideale kundër grushteve hidraulike në rrjetin e ujit.

Gjithashtu, për të evituar dëmtimet që mund të vijne nga një funksionim eventual me dërgim të mbyllur, pompat e shërbimit janë parashikuar me dalje për by-pass-in e qarkullimit të tyre.

Për të rritur sigurinë për motorrat elektrikë të pomave të zjarrit do të rezervohet furnizimi automatik me energji edhe nga rrjeti i motogeneratorit.

Sikurse e kemi theksuar më sipër, tubacionet e jashtëm të furnizimit me ujë do të jenë me material plastik PEHD, PN20 për eleminim e korrodimeve, ndërsa brenda ndërtesës të jenë me tub çeliku pa tegel me mure të trashë.

Për ambiente te veçanta sikurse ajo e IT, do të parashikohet mbrojtje me gaz Nr.2, si dhe sisteme të tjera si aerosol, pluhur, etj.

Po kështu, për ambientin teknik sigurimi nga zjarri duhet të parashikojë impiante me shkumë për mbrojtjen e depozitave të karburantit, si dhe sisteme “deluge” për mbrojtjen e transformatorëve dhe gjeneratorin.

**STUDIM-PROJEKTIM**  
**“NDËRTIM I QENDRËS MULTIFUNKSIONALE DHE PARKIMIT NËNTOKESOR,**  
**BASHKIA BERAT”**

## **5.7 Projekti Konstruktiv**

Sic eshte permendur edhe me siper, si dhe duke qene se zona e siperme multifunksionale eshte ne vazhdueshmeri te parkimit nentokesot gjatë hartimit të projektit duhen pasur parasysh Studimet Urbanistike te qytetit te Beratit. Per hartimin e projektit konstruktiv duhet te merren parasysh Eurokodet si me poshte:

- Eurokod 1: Ngarkesat që veprojnë në ndërtesa,
- Eurokod 8: Projektimi i ndërtesave rezistente ndaj tërmeteve,
- Eurokod 3: Projektimi i strukturave metalike, ENV 1993,
- Eurokod 2: Projektimi i strukturave b/arre, ENV 1992,
- Eurokod 7: Projektimi i themeleve

Në eurocode janë të percaktuara me detaje llojet e ngarkesave (të përhershme, të përkohëshme, borë dhe erë si dhe kombinimet e tyre) të cilat duhen marë në konsideratë gjatë analizimit të strukturës. Përpara hartimit të projektit duhet të merret parasysh studimi gjeologjik dhe sismik për terrenin në të cilin ndërtohet objekti.

## **5.8 Sinjalistika**

Një zë shumë i rëndësishëm në këtë detyrë është pikërisht të komunikuarit dhe të orientuarit me tabelat, sinjale dhe truke arkitektonike që bëjnë të mundur një orientim të pavetëdijshëm të qytetareve. Duhet të parashikohen tabela standarde për brenda dhe jashtë objektit. Gjithashtu te parashikohen dhe tabelat e evakuimit me ndricim.

# **6 FAZAT E PROJEKTIMIT**

Projekti per objektin “Ndërtim i qendrës multifunksionale dhe parkimit nëntokesor, bashkia Berat” do të mbështet në fazat e VKM Nr. 354, datë 11.05.2016, Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim , duhet te kaloje ne keto faza:

## **6.1 Faza I – Analiza e detyres se projektimit**

- A. Analiza e detyrës së projektimit/termave të referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit (format A4)
- B. Vëzhgimi dhe mbledhja e dokumenteve hartografike për zonën në të cilën duhet ndërrhyrë - (formati A3/A2).

Materiali grafik i përgatitur nga konsulenti duhet të përfshijë:

- Pozicionimin në harte;
- Përshkrimin e situatës aktuale;
- Verifikimin e projekteve/studimeve të miratuara për zonën objekt studimi etj.

Fletët grafike do të përgatiten bazuar në vrojtimin; ato duhet të janë lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme. Materialet dorëzohen në 1 kopje format hard copy (të printuar) dhe 1 cd në format soft copy (cad, exel, word).

## **6.2 Faza II – Projekt Ide paraprake**

Përpunimi pjesëve të rëndësishme të një zgjidhjeje të detyrës së planifikimit, e cila do paraqitet në jo më pak se 2 variant-propozime, ku për secilin variant do dorëzohet:

**STUDIM-PROJEKTIM**  
**“NDËRTIM I QENDRËS MULTIFUNKSIONALE DHE PARKIMIT NËNTOKESOR,  
BASHKIA BERAT”**

- Analiza e e bazës materiale dhe e parimeve;
- Vlerësimi i ndërtimeve ekzistuese (evidentimi i objekteve që prishen/ruhen)
- Vizatimet teknike: planimetri të përgjithshme, planvendosje, projekt mnz, elektrik, projektet mekanike, fasadat në 2D, imazhe render te jashtme te pakten 4, dhe 2 imazhe render te hapesirave te brendshme.
- Relacion teknik (mbi ndërhyrjet e parashikuara);
- Preventiv paraprak.

Varianti me treguesit më social - ekonomik dhe teknik, që do të përzgjidhet nga Këshilli Teknik, do të vazhdojë procedurën e hartimit të projekt-idesë përfundimtare.

(Të paraqiten variantet e propozuar me preventivat paraprake e specifikimet përkatëse duke përfshirë dhe kostot e shpronësimeve, nëse ka, për secilin variant).

Materialet dorëzohen në 1 kopje format hard copy (të printuar) dhe 1 cd në format soft copy (cad, exel, word).

### **6.3 Faza III – Projekt ide perfundimtare**

Përpunimi i zgjidhjes përfundimtare të detyrës së planifikimit. Në këtë fazë konsulenti duhet të përgatisë projekt idenë përfundimtare të ndërhyrjeve, pas miratimit në Këshill Teknik të variantit socio-ekonomik dhe teknik më të përshtatshëm të miratuar në fazën e projekt idesë-paraprake, e cila duhet të përbajë:

- Raport teknik;
- Preventivin e punimeve sipas formatit të miratuar nga Bashkia Berat, referuar vendimit nr. 216, datë 13.4.2023 për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar përinformatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim.
- Vizatimet teknike për të gjitha punimet e parashikuara me detajet përkatëse dhe skemen e organizimit te hapesirave.
- Specifikimet teknike për zërat e punimeve, që do të kryhen;
- Grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të punës;
- Rilevimi;
- Studimi gjeologjik.

Materialet dorëzohen në 1 kopje format hard copy (të printuar) dhe 1 cd në format soft copy (cad, exel, word).

Pranë Drejtoreve përkatëse të Bashkisë dhe institucioneve në varësi, kryhet aplikimi, nga ana e operatorit ekonomik të kontraktuar për hartimin e studim-projektimit, për vendosjen në dispozicion të informacionit në lidhje me azhornimet inxhinierike, statusin juridik të pronës etj.

### **6.4 Faza IV – Projekti per miratimin e lejes se ndertimit**

Përpunimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurat e nevojshme juridike e ligjore.

Projektuesi gjithashtu duhet të parashikojë dhe projektin për miratimin e lejes së ndërtimit, si i cili duhet të mbështetet në ligjin Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”.

Për këtë për çdo dokumentacion të nevojshëm për hartimin e projektit si dhe për aplikimin për leje ndërtimi përmes portalit të Regjistrat të Integruar të Territorit, të bashkëpunohet me Drejtoretë përkatëse të Bashkisë Berat.

**STUDIM-PROJEKTIM**  
**“NDËRTIM I QENDRËS MULTIFUNKSIONALE DHE PARKIMIT NËNTOKESOR,**  
**BASHKIA BERAT”**

Materialet dorëzohen në 2 kopje cd (projekti dhe dokumentacioni shoqërues me vulë elektronike).

### **6.5 Faza V – Projekt Zbatimi**

Përpunimi dhe paraqitja e planit të zgjidhjes së gatshme për zbatim. Dosja e plotë e projektit të zbatimit për objektin duhet të përmbarajë:

1. Raportet teknike (konstruktiv, arkitektonik, topografik, gjeologjik, hidroteknik, elektrik, kondicionimi, eficenza energjetike, kush/kuz.). Raporti përfundimtar teknik përfshin të gjitha informacionet në lidhje me projektin, duke shpjeguar arsyet në të cilat u bazua skema e detajuar e projektit. Ai përshkruan analizën e bërë nga projektuesi për situatën dhe projektin e propozuar
2. Projektin arkitektonik: Relacion arkitektonik i objektit, Fasadat, Planimetritë ekzistuese dhe të reja të objektit, Prerjet e godinës, Plan mobilimin e ambienteve, Plani i mbulesës, etj;
3. Projektin e zbatimit/konstruksionin të objektit: Plani i strukturave dhe detajet, Plani i themelive, etj.
4. Projekt Zbatimin e instalimeve hidrosanitare, të kanalizimeve
5. Projekt Zbatimin e instalimeve elektrike, të shoqëruara me licencën e noteruar të projektuesit
6. Projekt Zbatimin e instalimit te sistemit të ngrohjes, të mbrojtjes kundër zjarrit të strukturës të miratuar nga Drejtoria e Zjarrit dhe Shpëtimit
7. Projektin e sistemimit;
8. Rilevimin topografik
9. Studimin gjeologo-inxhinierik
10. Studimi sismologjik
11. Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të largimit të ujërave të shiut;
12. Rekomandime për materialet e ndërtimit që do të përdoren
13. Relacionin gjeologjik
14. Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza;
15. Projektin e zbatimit të rrjetit të ujësjellësit, përfshirë dhe detajet e pusetave të pajisjeve dhe rakorderive të nyjeve, etj;
16. Specifikimet teknike për zërat e punimeve që do të kryhen. Kontraktuesi duhet të përgatisë specifikimet teknike për secilën material që do të përdoret.
17. Preventivin e punimeve mbështetur në manualet teknike të çmimeve në fuqi;
18. Grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të punës, si dhe te percaktohet fuqia punetore(llojin e specialisteve) dhe makinerite e nevojshme (llojin e tyre) per realizimin e ketij objekti;
19. Plan organizimin e punimeve dhe ngritjen e kantierit në funksion të mjeteve, që do të janë pjesë e realizimit të objektit, mbështetur dhe në grafikun e punimeve;
20. Raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM);
21. Liçensë të firmës projektuese, liçensë të ekspertit mjedor dhe ekstrakt i regjistrat tregtar.
22. Deklaratat e përgjegjësisë profesionale të stafit pjesmarrës në realizimin e studim-projektimit

Materialet dorëzohen në 5 kopje format hard copy (të printuar) dhe 5 cd (4 cd në format soft copy cad, exel, word etj dhe 1 cd në format pdf).

### **6.6 Faza VI – Hartimi i Preventivit Perfundimtar**

Për hartimin e preventivit projektuesi duhet të mbështetet në vendimin nr. 216, datë 13.4.2023 për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar përinformatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim.

**STUDIM-PROJEKTIM**  
**“NDËRTIM I QENDRËS MULTIFUNKSIONALE DHE PARKIMIT NËNTOKESOR,  
BASHKIA BERAT”**

Për secilin zë punimi, i cili nuk është i përfshirë në këtë manual, projektuesi duhet të dorëzojë analizat/ofertat përkatëse të çmimeve.

#### 6.6.1 Certifikata e Performances se Energjise

Gjithashtu per kete project bazuar ne ligjin Nr.124/2015 “Per Eficensen e Energjise” si dhe Vendimit Nr.537 , date 08/07/2020 “Per Miratimin e kerkesave minimale te Performances se Energjise se Ndertesave dhe elementeve te ndertesave duhet te realizohet: Raporti I Auditimit te Energjise dhe Certifikata e Performances se Energjise.

## 7 REKOMANDIME PER PROJEKTUESIN

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standarde për projektim që parashikon legjislativën në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafshimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës. Në hartimin e projektit të mbahen parasysh të gjitha normat e miratuar për personat me aftësi të kufizuar, të verbit, etj. Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori. Standarde në paraqitjen e dokumentacionit teknik:

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkua kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, më të avancuara të fushës.

### 7.1 Tabela e Siperfaqeve te Projektimit

Emertimi	Siperfaqja
• Parkim nentokesor dy kate nen toke	≈8500÷9000 m <sup>2</sup>
• Muze Historik	≈200 m <sup>2</sup>
• Programacion dhe Coddy school	≈250 m <sup>2</sup>
• 3D modeling dhe Animacion	≈300 m <sup>2</sup>
• Fotografi	≈270 m <sup>2</sup>
• Graphic Design dhe Robotika	≈250 m <sup>2</sup>
• Laborator dhe After School	≈300 m <sup>2</sup>
• Verande e gjelberuar/shfrytezuar publike (mbi të gjitha sallat)	≈780 m <sup>2</sup>
• Rivitalizim i hapesires se gjelberuar	≈3720 m <sup>2</sup>

**Shenim:** Siperfaqet e mesiperme jane indikative / orientuese dhe do te jene subjekt ndryshimi sipas kerkesave qe mund te paraqesi Autoriteti Kontraktor.

**STUDIM-PROJEKTIM**  
**“NDËRTIM I QENDRËS MULTIFUNKSIONALE DHE PARKIMIT NËNTOKESOR,**  
**BASHKIA BERAT”**

## **8 PARAQITJA E VIZATIMEVE**

Vizatimet duhet të jenë të lexueshme dhe të përbajnë si minimum fletët si më poshtë:

1. Topografinë e gjendjes ekzistuese në të cilën të jenë të azhornuara të gjitha ndërtimet në gjendjen e sotme (me leje dhe pa leje)
2. Zhvillimi i koncept idesë për objektin
3. Planvendosjen e objektit në Shk 1:100
4. Planimetria e përgjithshme e objektit në Shk. 1:200; 1:500
5. Fasadat në 2D dhe 3D Shk.1:100
6. Prerjet e godinës (në të dy drejtimet) Shk.1:100
7. Planin e tarrace ose catise Shk.1:100
8. Planimetria e themelive Shk.1:100
9. Prerje të themelive dhe detajet Shk.1:20; 1:10
10. Plani i strukturave detaje Shk.1:100; Shk.1:50
11. Planimetritë e mobilimit Shk.1:100
12. Planimetria e rrjetit të kanalizimeve në shkallën Shk. 1: 100
13. Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të kanalizimeve Shk.1:10, 1:20
14. Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të ujësjellësit Shk.1:20, 1:10
15. Skemat aksonometrike të furnizimit me ujë, detaje të pajisjeve hidrosanitare Shk.1:100
16. Planimetria dhe detaje të sistemit te mbrojtjes kundër zjarrit Shk.1:100
17. Planimetria, dhe detaje të sistemit të ngrohjes Shk.1:100
18. Planimetria e dhomës së kaldajës, konstruksioni, detaje Shk.1:100;1:50
19. Planimetri dhe detaje për ndriçimin. Shk.1:100;1:50
20. Planimetria e skemës së shpërndarjes së fuqisë në të gjithë objekti, Shk. 1:100
21. Planimetritë për telefoninë, rrjetin e internetit Shk.1:100; 1:50
22. Planimetria e ndriçimit të jashtëm dhe detaje të tij Shk.1:100; 1:50
23. Planimetria disiplinimit dhe shkarkimit të ujërave sipërfaqësore dhe detajet përkatëse shk.1: 100; 1:50.
24. Plan qarkullimi i personave me aftesi te kufizuar
25. Planvendosja e objektit në shkallën 1: 1000 format A3;

Të gjitha fletët e vizatimeve duhet të jenë të detajuara me elementët përkatës, si dhe legjendat përkatëse.

Relacionet shoqëruese:

1. Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis
2. Raport elektrik
3. Raport teknik
4. Raport hidro, kush, kuz
5. Raport konstruktiv+ llogarijet e struktures
6. Raport i sistemeve mekanike, ngrohje – ftohje, mnz. Et...
7. Raport arkitektonik
8. Raport teknik
9. Preventiv
10. Rilevimi
11. Studimi sizmiologjik
12. Studimi gjeologjik
13. Grafiku i punimeve
14. Licensat e stafit projektues

**STUDIM-PROJEKTIM**  
**“NDËRTIM I QENDRËS MULTIFUNKSIONALE DHE PARKIMIT NËNTOKESOR,**  
**BASHKIA BERAT”**

15. Deklaratat e stafit pjesmarres ne hartimin e projektit
16. Raporti I Eficnecë se Energjise dhe Certifikata e Performances se Energjise

## **9 Afatet e dorezimit dhe raportimi dhe dorezimi final**

Afatet e dorezimit

Pershkrimi	Kohe gjatja
Faza I Analiza e Detyres se Projektimit	20 dite
Faza II Projekt ide paraprake	30 dite
Faza III Projekt ide Perfundimtare	30 dite
Faza IV -Projekt per miratimin e Lejes se Ndertimit	70 dite
FAZA V Projekt I Zbatimit	
Faza VI Preventivi perfundimtar	20 dite
Faza VII Eficenca Energjise	10 dite

Dorëzimi final, fizik, i projektit të zbatimit, do të konsiderohet ai, i cili do të ketë kaluar njëherë të gjitha fazat e mësipërme dhe projekti do t'i nënshtronhet oponencës teknike të Institutit të Ndërtimit, sipas afateve përkatësë. (të miratuara nga Bashkaia Berat).

Ne afatet e dorëzimit përfshihet dhe koha 10 ditore per komentet e klientit për secilën fazë.

Dorëzimi i dokumentacionit do të bëhet në rrugë zyrtare shoqëruar me fletë inventari te detajuar me nr. Fletesh.

Të gjitha dokumentat e printuara duhet të janë të firmosura e vulosura në original nga të gjithë projektuesit.

Materialet dorëzohen në 5 kopje format hard copy (të printuar) dhe 5 cd (4 cd në format soft copy cad, exel, word etj, dhe 1 cd në format pdf)

Gjithashtu do dorëzohet versioni i dixhitalizuar i cili transferohet në GIS.

## **10 INVESTIMI THEMELOR**

Investimi themelor do të dalë nga varianti më i mirë i miratuar nga Këshilli Teknik i Bashkisë së Beratit.

Projektuesi është përgjegjës të sigurojë saktësinë dhe pajtueshmërinë me të gjitha standartet dhe normat përkatëse.Të dhënat e nevojshme për projektim, sikurse janë: gjendja e rrjetit ekzistues të ujësjellësit, të kanalizimeve, ndriçimit, kabinat e stensionit të lartë, vendosja e kontenierëve, planin rregullues të zonës, etj, do të merren nga projektuesi sipas formularëve përkatës.

### **10.1 Referencat**

Referenca te pergjithshme

Normat ISO per ndertimLigjet e tjera te Republikes se Shqiperise, duke perfshire Ligjin per mbrojtjen e Mjedisit, Ligjin per Planifikimin e Territorit , rregulloret per mbrojtjen nga zjarri, Ligjet e ndertimit, udhezim per Kushtet Teknikë te objekteve ndertimore per Qasjen e Personave me aftesi te kufizuar , Rregullore Teknikë per kursimin e energjise termike dhe mbrojtjen termike ne ndertesa .